



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
Shkolla e Mesme Profesionale
"Charles Telford Erickson"
Golem – Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0693870484 .

Nr 173 prot

Golem më 16, 04, 2024.

Lenda: Njoftim per vend pune te lire.

Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerezire
Drejtoria e Maredhenieve me Publikun
Agjensia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive

Në mbështetje të Ligjit nr.15/2019 "Per nxitjen e punesimit", Ligjit nr.15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", Udhëzimit nr.14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson" Golem-Kavaje, ju njofton krijimin e vendit te lire per 1 pozicion pune:

Specialist Finance.

1.Kriteret e pergjithshme dhe kriteret e posacme.

Aplikanti duhet te plotesoje kriteret e pergjithshme per vendin e lire te punes si vijon:

1. Kriteret e pergjithshme:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit.
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Aplikanti duhet te plotesoje kriteret e posacme për specialist finance ne ofruesit e AFP-se si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë të nivelit *Bachelor*, në shkenca ekonomike, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të ngjashme, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit dosja e aplikimit, e cila permban dokumentacionin e kerkuar, sipas njoftimit per vendin e lire te punes, duhet te perfshije:

- a) Letërmotivimin për pozicionin.
 - b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi.
 - c) Kartën e identitetit.
 - d) diplomën.
 - e) Librezën e punës.
 - f) Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
 - g) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
 - h) Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
 - i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
 - j) Vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi.
 - k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda dates. 26.04.2024.

Drejtore
Matilda Canaku

